Sot, më datë *18. 04.* 2007 (dymijë e shtatë), unë gjyqtarja *H. Muzoreva (D)*, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuesit Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë Tregtare "BANKA CREDINS" SH.A., z. Artan SANTO, përfaqësuar me autorizim nga Juristja Romina Meli për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme, datë 18.04.2007 për miratimin e raportit dt. 02.04.2007 të Ekspertit Kontabël të Autorizuar z. Theodhoraq GJOSHA, të caktuar sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969/8, datë 30.03.2007 për zmadhimin e kapitalit aksioner të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., si dhe bërjen e ndryshimeve përkatëse në Statutin e shoqërisë,

KONSTATOVA SE

Shoqëria Tregtare "BANKA CREDINS" SH.A. është rregjistruar si Person Juridik, në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003 dhe ushtron veprimtarinë e saj, konform akteve të themelimit të shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuesi, z. Artan SANTO, me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A. ka paraqitur kërkesën për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme, datë 18.04.2007. Me anë të këtij vendimi të asamblesë, është vendosur miratimi i raportit datë 02.04.2007 të Ekspertit Kontabël të Autorizuar z. Theodhoraq GJOSHA, të caktuar sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969/8, datë 30.03.2007, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A. në shumën 768.177 USD (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë USD), nëpërmjet përfshirjes në kapital të fitimeve të mbartura të pashpërndara të realizuara gjatë vitit ushtrimor 2005.

Kapitali i Shoqërisë Tregtare "BANKA CREDINS" SH.A., pas këtij zmadhimi është në vlerën 11.382.332 USD (njëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e dy dollarë amerikan).

Ky Vendim i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve është marrë në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., datë 18.04.2007, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., datë 18.04.2007, me anën e të cilit është vendosur zmadhimi i kapitalit nëpërmjet përfshirjes në kapital të fitimeve të mbartura të pashpërndara të realizuara gjatë vitit ushtrimor 2005, zmadhim i cili e con vlerën e kapitalit të "BANKA CREDINS" SH.A. në vlerën 11.382.332 USD (njëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e dy dollarë amerikan).
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për kryerjen e ndryshimeve në kollonën përkatëse të Regjistrit Tregtar.

Kundër vendimit lejohet ankimimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E
Mariane Nysani Deo
Dobroshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Nr. 28969 i Vendimit
/12

VENDIM
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 13/1/2007 (dymijë e shtatë), unë gjyqtarja M. Dafa, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkuesit Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Tregtare "BANKA CREDINS" SH.A., z. Artan SANTO, përfaqësuar me autorizim nga Juristja Romina Meli për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme, datë 29.12.2006 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., si dhe bërjen e ndryshimeve përkatëse në Statutin e shoqërisë,

KONSTATOVA SE

Shoqëria Tregtare "BANKA CREDINS" SH.A. është rregjistruar si Person Juridik, në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003 dhe ushtron veprimtarinë e saj, konform akteve të themelimit të shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkesi, z. Artan SANTO, me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A. ka paraqitur kërkesën për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme, datë 29.12.2006.

Me anë të këtij vendimi të asamblesë, u vendos miratimi i z. Stavri Prifti, si ekspert kontabël i autorizuar për zmadhimin e kapitalit themeltar dhe po ashtu u vendos dhe miratimi i raportit të tij, për vlerësimin e rrritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja.

Po kështu Asambleja e aksionerëve pas shqyrtimit të Raportit të Drejtorisë dhe Raportit të Ekspertit Kontabël Stavri Prifti, vendosi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në masën 5.26% të kapitalit të rritur që përfaqëson 599.070 (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë) aksione dhe emetimi i këtyre aksioneve të reja duke e cuar kapitalin e shoqërisë në 11.981.403 USD (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tre dollarë amerikan).

Në të njëjtën kohë, asambleja ka vendosur heqjen e të drejtës së përparësisë në nënshkrim nga aksionerët ekzistues dhe ia ka ofruar këtë paketë aksionesh palës së tretë, EMIGRES SL, duke e bërë atë aksionere të BANKA CREDINS SH.A., me 5 % të kapitalit të rritur.

Pas këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë tregtare "BANKA CREDINS" SH.A. është në vlerën 11.981.403 USD (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tre dollarë amerikan), ku shoqëria EMIGRES SL zotëron 5 % (pesë për qind) të kapitalit të rritur .

Asambleja ka ngarkuar drejtorinë me ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për realizimin e këtij transaksioni deri në regjistrimin në regjistrin tregtar.

Ky Vendim i Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve është marrë në bazë të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", statutit të shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., datë 29.12.2006, është plotësish e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit Nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., datë 29.12.2006, për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "BANKA CREDINS" SH.A. i cili, u rrit me 5.26%. Pas kësaj vlera e kapitalit themeltar arriți vlerën **11.981.403 USD** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tre dollarë amerikan), ku shoqëria **EMIGRES SL** zotëron 5 % (pesë për qind) të kapitalit të shoqërisë.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrit Tregtar për kryerjen e ndryshimeve në kollonën përkatëse.

Kundër vendimit lejohet ankimimi sipas ligjit.

G J Y Q T A R E


Nr

Rregjistrimi .

URDHER RREGJISTRIMI

28969

Emri : "Banko Credins, M.-A.

Selia : N "Ismael Devali, Nr 21, Finance"

Objekti: Finans, għaddekk u depositi kifet et".

Kapitali : 5.250.000 USD.

Aħxa aktar : "Credins, Sliq, A. Pilo, M. Mifsud, R. Tindalea, A. Sard, Q. Mamo, M. Zorkeh, "Times Bevilett", A. Għerba, J. Ħeġi, E. Baci, X. Feneo".
Administrator: Kieniwilli D-Registru

Kohezgatja : ja għajnej

Statuti : 20 (njiex) jleħi

Akti i Themelimit : 6 (ejas-sut) jleħi.

Data e nenshkrimit te Statutit : 31. 01. 2003


Data e Rregjistrimit : 31. 01. 2003

Shenime - Nr illoġġie 13220/01/0944

GJYQTARE
Bicċina ufe
Dee/-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
V. 28969 Vendimit



V E N D I M


PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot, më datë 31.01.2003, unë Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Blerina MUÇI, pasi shqyrtova kërkuesën e kërkuesit Artan Santo, i cili më kërkoi regjistrimin e Shoqërisë Anonime "BANKA CREDINS" Sh.a. si Person Jurdik Privat,

K O N S T A T O V A :

Kërkuesi Artan Santo, me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Anonime në formim e sipër, "BANKA CREDINS" sh.a., person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, kërkon të regjistrojë Shoqërinë Anonime "BANKA CREDINS" Sh.a, me seli në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë, me objekt të veprimitarës në përputhje me licënsën e marrë:

- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozitat bankare;
- b) të japë kredi;
- c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
- ç) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtiveve;
- d) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- dh) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- e) të ushtrojë qerane financiare;
- ë) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
- f) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- g) të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve metale te çmuara;
- gj) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare, ketu nuk perfshihen shërbimet e parashikuara ne germën (a) dhe (b);
- h) të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore;
- i) të ushtroje shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
- j) të ushtroje shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;



9. Asllan Grezda zoteron 139.690 (njeqind e tridhjete e nente mijë e gjashteqind e nentëdhjete) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 139.690 (njeqind e tridhjete e nente mijë e gjashteqind e nentëdhjete) USD te cilat perbejne 2.66% te kapitalit themeltar.
10. Sejdin Zere zoteron 68.975 (gjashtedhjete e tete mijë e nenteqind e shtatedhjete e pese) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 68.975 (gjashtedhjete e tete mijë e nenteqind e shtatedhjete e pese) USD te cilat perbejne 1.31% te kapitalit themeltar.
11. Elena Daci zoteron 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.
12. Leonat Koço zoteron 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.

Afati i shoqërisë është me një kohëzgjatje pa afat.

Shoqëria do të ketë organet e saj si më poshtë:

1. Asamblea e Aksionerëve;
2. Këshilli Drejtues, i cili përgjigjet për administrimin dhe mbikqyrjen e manaxhimit të Shoqërisë me këtë përbërje: Maltin Korkuti, Artan Santo, Monika Milo, Ilirjan Bushati, Skënder Dishani, Artan Hajdari dhe Maksim Haxhia;
3. Drejtoria e cila përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm Zoti Artan Santo, Zëvendës Drejtori i Parë Zonja Monika Milo dhe Zëvendës Drejtori i Dytë Zoti Maltin Korkuti.

Kjo mënyrë organizimi rregullohet në bazë të ligjit Nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton shprehimisht se nëndarja II e pjesës së IV të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" nuk zbatohet për bankat.

Për sa më sipër, kërkesa e bërë prej saj është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar" e ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S A :

Të regjistrojë si Person Juridik Privat, Shoqërinë Anonime "BANKA CREDINS" sh.a. me seli në qytetin e Tiranës, adresë: Rruga "Ismail Qemali" Nr. 21, Tiranë, me objekt të veprimtarisë në përputhje me licënsën e marrë:

- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozitat bankare;



- b) të japë kredi;
- c) të marrë huà mjete financiare dhe të blejë ose të shesë pér llogari të saj apo pér llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me nonnat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
- ç) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- d) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- dh) të ndërmjetësojë pér transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- e) të ushtrojë qerane financiare;
- ë) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
- f) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- g) të blejë ose të shesë pér llogari të saj apo pér llogari të klientëve metale te cmuara;
- gj) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare, ketu nuk perfshihen sherbimet e parashikuara ne germën (a) dhe (b);
- h) të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) pér këmbime valutore;
- i) të ushtroje shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
- j) të ushtroje shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit pér investimet;
- k) të ushtroje shërbime pér nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë pér llogari të saj ose të klientëve.
- l) të ushtrojë veprimitari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

Në përputhje me legjislacionin, pér të arritur qëllimet e përmendura, pervec aktiviteteve kryesore, shoqeria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter favorizues, ndihmes, aksesor, lethesues, perfittues, aksidental dhe okazional i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimitarise së Shoqërisë.

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 5.250.000 USD.

Aksionerë të shoqërisë janë:

1. Credins sh.a. zoteron 2.169.615 (dymilion e njeqind e gjashtedhjete e nente mijë e gjashteqind e pesembedhjete) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 2.169.615 (dymilion e njeqind e gjashtedhjete e nente mijë e gjashteqind e pesembedhjete) USD te cilat perbejne 41.33% te kapitalit themeltar.
2. Aleksander Pilo zoteron 837.331 (teteqind e tridhjete e shtate mijë e treqind e tridhjete e një) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 837.331



- (teteqind e tridhjete e shtate mijë e treqind e tridhjete e nje) USD te cilat perbejne 15.95% te kapitalit themeltar.
3. Muamet Malo zoteron 770.096 (shtateqind e shtatedhjete mijë e nentedhjete e gjashte) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 770.096 (shtateqind e shtatedhjete mijë e nendedhjete e gjashte) USD te cilat perbejne 14.67% te kapitalit themeltar.
 4. Renis Tershana zoteron 420.000 (katerqind e njezet mijë) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 420.000 (katerqind e njezet mijë) USD te cilat perbejne 8% te kapitalit themeltar.
 5. Artan Santo zoteron 308.040 (treqind e tete mijë e dyzete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 308.040 (treqind e tete mijë e dyzete) USD te cilat perbejne 5.87% te kapitalit themeltar.
 6. Monika Milo zoteron 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) USD te cilat perbejne 2.93% te kapitalit themeltar.
 7. Maltin Korkuti zoteron 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) USD te cilat perbejne 2.93% te kapitalit themeltar.
 8. Firma "Bushati" shpk zoteron 123.215 (njeqind e njezet e tre mijë e dyqind e pesembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 123.215 (njeqind e njezet e tre mijë e dyqind e pesembedhjete) USD te cilat perbejne 2.35% te kapitalit themeltar.
 9. Asllan Grezda zoteron 139.690 (njeqind e tridhjete e nente mijë e gjashteqind e nendedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 139.690 (njeqind e tridhjete e nente mijë e gjashteqind e nendedhjete) USD te cilat perbejne 2.66% te kapitalit themeltar.
 10. Sejidin Zere zoteron 68.975 (gjashtedhjete e tete mijë e nenteqind e shtatedhjete e pese) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 68.975 (gjashtedhjete e tete mijë e nenteqind e shtatedhjete e pese) USD te cilat perbejne 1.31% te kapitalit themeltar.
 11. Elena Daci zoteron 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.
 12. Leonat Koço zoteron 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.


Afati i shoqërisë është me një kohëzgjatje pa afat.

Shoqëria do të ketë organet e saj si më poshtë:

1. Asamblea e Aksionerëve;
2. Këshilli Drejtues, i cili përgjigjet për administrimin dhe mbikqyrjen e manaxhimit të Shoqërisë me këtë përbërje: Maltin Korkuti, Artan Santo,

- 
- Monika Milo, Ilirjan Bushati, Skënder Dishani, Artan Hajdari dhe Maksim Haxhia;
 - Drejtoria e cila përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm Zoti Artan Santo, Zëvendës Drejtori i Parë Zonja Monika Milo dhe Zëvendës Drejtori i Dytë Zoti Maltin Korkuti.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.



G J Y Q T A R E



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ANONIME "BANKA CREDINS SH.A."**



Aksioneret themelues:

1. Instituti Financiar Credins sh.a., me seli ne Rr. "Ismail Qemali" Nr. 11, Tirane e perfaqsuar nga administratorja zj. Monika Milo.
2. Aleksander Pilo, I datelindjes 08.04.1963 banues ne Rr. "Bajram Curri" Pall. 11 Shk. 1 Ap.7 Tirane.
3. Muamet Malo, I datlindjes 13.05.1957, banues ne Rr. "Lek Dukagjini" Pall 11 Tirane.
4. Renis Tershana, I datlindjes 23.09.1971, banues ne Rr. "Shyqiri Ishni" Nr. 17 Tirane.
5. Artan Santo, I datlindjes 07.09.1956, banues ne Rr. "Margarita Tutulani" Pall. BK Ap. 8, Tirane.
6. Monika Milo, e datlindjes 07.10.1967, banuese ne Rr. "Pjeter Bogdani" Pall. 23/1 Ap.8, Tirane.
7. Maltin Korkuti, I datlindjes 17.01.1967, banues ne Rr. "Mihal Grameno" Pall. 11 Ap. 9 Tirane.
8. Firma Bushati shpk, me seli ne Tirane e perfaqsuar nga z.Illirjan Bushati
9. Asllan Grezda, I datlindjes 08.03.1933, banues ne Rr. "e Kavajes" Pall.7, Tirane
10. Sejdin Zere, I datelindjes 02.04.1959, banues ne Rr. "Pjeter Bogdani" Pall. 23 Ap. 8 Tirane.
11. Elena Daci, e datlindjes 18.11.1952, banuese ne Rr. "Perlat Rexhepi" P12, Ap. 103.
12. Leonat Koco, I datlindjes 11.01.1974, banues ne Rr."Ismail Qemali"Nr. 31 Tirane.

Bien dakort te krijojne dhe rregistrojne shoqerine anonime Banka Credins Sh A sipas ligjit, akteve nenligjore, standarteve nderkombetare, praktikave me te mira bankare, marrëveshjes se ortakeve dhe statutit si me poshte :

1 – Krijimi, Emërtimi, Kohezgjatja dhe Forma Juridike e Shoqërisë

- 1.1 Banka Credins Sh.A. eshte shoqeri anonime.
- 1.2 Emërtimi i shoqerise eshte "BANKA CREDINS SH.A." (si me poshte "Shoqeria").
- 1.3 Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Rr. Ismail Qemali Nr.21 Tirane.

Objekti
PRANE

Në përputhje me licencën e marrë, Shoqëria ka të drejtë:

- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozitat bankare;
- b) të japë kredi;
- c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klienteve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
- d) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- e) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- f) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- g) të ushtrojë qerane financiare;
- h) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
- i) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- j) të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klienteve metale të cmuara;
- k) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare, ketu nuk perfshihen shërbimet e parashikuara ne pikën 3.1, gjëma (a) dhe (b);
- l) të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore.
- m) të ushtroje shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
- n) të ushtroje shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
- o) të ushtroje shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klienteve.

QJ.

1) të ushtrojë veprimitari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

3.2 Në përputhje me legjislacionin, për të arritur qëllimet e përmendura, pervec aktiviteteve kryesore, shoqeria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter favorizues, ndihmes, aksesor, lehtesues, perfitues, aksidental dhe okazional i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimitarise së Shoqërisë.


4 - Kapitali Themeltar

4.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 5.250.000 (pesemilion e dyqind e pesedhjete mijë) USD

4.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është kapital aksioner i cili përbëhet nga 5.250.000 (pesemilion e dyqind e pesedhjete mijë) aksione per kontributin ne para me vlerë nominale prej 1 (nje) USD për aksion. Ne momentin e themelimit kapitali eshte shlyer teresist.

4.3 Kapitali aksioner ndahet si me poshtë:

1. Credins sh.a. zoteron 2.169.615 (dymillion e njeqind e gjashtedhjete e nente mijë e gjashteqind e pesembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 2.169.615 (dymillion e njeqind e gjashtedhjete e nente mijë e gjashteqind e pesembedhjete) USD te cilat perbejne 41.33% te kapitalit themeltar.
2. Aleksander Pilo zoteron 837.331 (teteqind e tridhjete e shtate mijë e treqind e tridhjete e nje) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 837.331 (teteqind e tridhjete e shtate mijë e treqind e tridhjete e nje) USD te cilat perbejne 15.95% te kapitalit themeltar.
3. Muamet Malo zoteron 770.096 (shtateqind e shtatedhjete mijë e nentedhjete e gjashte) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 770.096 (shtateqind e shtatedhjete mijë e nentedhjete e gjashte) USD te cilat perbejne 14.67% te kapitalit themeltar.
4. Renis Tershana zoteron 420.000 (katerqind e njezet mijë) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 420.000 (katerqind e njezet mijë) USD te cilat perbejne 8% te kapitalit themeltar.
5. Arta Santo zoteron 308.040 (treqind e tete mijë e dyzete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 308.040 (treqind e tete mijë e dyzete) USD te cilat perbejne 5.87% te kapitalit themeltar.
6. Monika Milo' zoteron 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) USD te cilat perbejne 2.93% te kapitalit themeltar.

- 
7. Maltin Korkuti zoteron 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater miye e nentembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater miye e nentembedhjete) USD te cilat perbejne 2.93% te kapitalit themeltar.
 8. Firma "Bushati" shpk zoteron 123.215 (njeqind e njezet e tre miye e dyqind e pesembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 123.215 (njeqind e njezet e tre miye e dyqind e pesembedhjete) USD te cilat perbejne 2.35% te kapitalit themeltar.
 9. Asllan Grezda zoteron 139.690 (njeqind e tridhjete e nente miye e gjashteqind e nentehjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 139.690 (njeqind e tridhjete e nente miye e gjashteqind e nentehjete) USD te cilat perbejne 2.66% te kapitalit themeltar.
 10. Sejdin Zere zoteron 68.975 (gjashtedhjete e tete miye e nenteqind e shtatedhjete e pese) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 68.975 (gjashtedhjete e tete miye e nenteqind e shtatedhjete e pese) USD te cilat perbejne 1.31% te kapitalit themeltar.
 11. Elena Daci zoteron 52.500 (pesedhjete e dy miye e peseqind) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy miye e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.
 12. Leonat Koço zoteron 52.500 (pesedhjete e dy miye e peseqind) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy miye e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.


5 - Organet e Drejtimit dhe Administrimit

5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga:

- a) Asamblea Aksionerëve;
- b) Këshilli Drejtues; dhe
- c) Drejtoria.

Organet e shoqerise per gjigjen per drejtimin dhe administrimin e shoqerise sipas statutit dhe akteve te tjera te shoqerise.

- 5.2 Asamblea e Aksionerëve eshte organi me i larte vendim-marrës i Shoqërisë.
- 5.3 Shoqëria drejtohet nga Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues per gjigjet per administrimin dhe mbikeqyrjen e manaxhimite Shoqerise.
- 5.4 Drejtoria perbehet nga Drejtori i Pergjithshem, Zevendes Drejtori i Pare dhe Zevendes Drejtori i Dyte. Drejtori i per gjithshem per gjigjet per manaxhimin dhe administrimin e perditshem te Shoqërisë. Drejtori i per gjithshem përfaqëson ligjërisht shoqërinë.



Shoqeria ka komitet kontrolli. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që
mbrohen nga asambleja e aksionerëve dhe ushtrojne detyrat e percaktuara nga ligji
dhe aktet nenligjore.

6 - Dispozita perfundimtare

Akt themelimi hyn ne fuqi ne daten e rregistrit ne rregjistrin tregtar.

Aksioneret

1. Instituti Financiar Credins sh.a., i perfaqsuar nga zj. Monika Milo.
2. Aleksander Pilo
3. Muammet Malo
4. Renis Tershana
5. Artan Santo
6. Monika Milo
7. Maltin Korkuti
8. "Bushati" shpk, perfaqsuar nga z. Ilijan Bushati
9. Asllan Grezda
10. Sejdin Zere
11. Elena Daci
12. Leonat Koco





Albin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 857 Rep.
Bf. 87 Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 31.01.2003, para meje noterit Dusho Dusha, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Zj. Monika Milo, përfaquese e Institutit Financiar Credins sh.a. me seli në "Rrugën Ismail Qemali" Nr. 11, Tirane, madhere, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, e datelindjes 07.10.1967, banuese ne rrugen Pjetër Bogdani, Pall. 23/1, ap.8, Tirane, me cilesine e administratores; Aleksandër Pilo, i datelindjes 08.04.1963, banues në Rrugën "Bajram Curri", Pall 11, shk.1 Ap. 7 Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Muhamet Malo, i datelindjes 13.05.1957, banues në rrugen "Lek Dukagjini" Pall. 11 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Renis Tërshana, i datelindjes 23.09.1971, banues në Rrugën "Shyqyri Ishmi" Nr. 17 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Artan Santo, i datelindjes 07.09.1956, banues ne Tirane ne adresen Ruga "Margarita Tutulani", Pall. BK, Ap. 8 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Maltin Korkuti, i datelindjes 17.01.1967, banues në Rrugën "Mihal Grameno" Pall 11, Ap. 9 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike per të vepruar, Ilirjan Bushati, i datelindjes 11.06.1954, banues ne Tirane, ruga Vaso Pasha, Nr.16, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Asllan Grezda, i datelindjes 08.03.1933, banues në Rrugën e Kavajës, Pall 7 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Sejdin Zere, i datelindjes 02.04.1959, banues në Rrugën "Pjetër Bogdani" Pall 23/1, Ap. 8, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Elena Daçi, e datelindjes 18.11.1952, banuese në Rrugën "Perlat Rexhepi", Pall 12, Ap 103, Tiranë, madhere, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar dhe Leonat Koço, i datelindjes 11.01.1974, banues në Rrugën "Ismail Qemali" Nr. 31 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, të gjithë të njojur personalisht prej meje, të cilët më deklaruan përmbytjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.





STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME
“BANKA CREDINS”

Statuti i “Banka Credins” Sh.A. bazohet në ligj, aktet nënligjore, standartet ndërkombëtare, praktikat më të mira bankare dhe në marrëveshjen e ortakëve aksionerë.

TITULLI I

Neni 1 - Krijimi dhe forma juridike e Shoqërisë

- 1.1 Banka Credins Sh.A. është person juridik privat.
- 1.2 Banka Credins Sh.A. është shoqëri anonime.
- 1.3 Banka Credins Sh.A. e ushtron veprimtarinë në të gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 - Emërtimi i Shoqërisë

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “BANKA CREDINS SH.A.” (si më poshtë “Shoqëria”).
- 2.2 Emërtimi i shoqërisë në formë të shkurtuar është “BC” Sh.A..

Neni 3 - Selia, Filialet, Degët, Agjensitë dhe Zyra e Përfaqësimit.

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë. Selia e Shoqërisë është vendodhja e drejtorisë. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të vendosë nëse selia dhe drejtoria mund të janë në vendodhje të ndryshme.
- 3.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të hapë ose mbyllë sili dytësore. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të transferojë selinë e shoqërisë. Këshilli Drejtues propozon dhe publikon transferimin e selisë. Procedurat dhe publikimi i transferimit përcaktohet nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve. Transferimi i selisë dhe ndryshimet në aktet e Shoqërisë hyn në fuqi në momentin e regjistrimit.
- 3.3 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, me miratim të Bankës së Shqipërisë, mund të hapë ose mbyllë filiale të Shoqërisë në Shqipëri dhe jashtë saj.
- 3.4 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, me miratim të Bankës së Shqipërisë, mund të hapë ose mbyllë degë të Shoqërisë jashtë Shqipërisë.

[Handwritten signatures and initials of the shareholders and directors]

3.5 Këshilli Drejtues mund të hapë ose mbylli çdo degë, agjensi dhe zyrë përfaqësimi, të përherershme apo jo të përhereshëm, në Shqipëri.

3.6 Përsa i përket marrëdhënieve midis Shoqërisë dhe aksionerëve, vendbanimi i secilit prej aksionerëve është ai i përcaktuar në regjistrin e aksionerëve.

Neni 4 - Logo dhe Vula

4.1 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve me propozim të Këshillit Drejtues përcakton logon dhe vulën e Shoqërisë.

4.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të ndryshojë pjesërisht ose plotësisht logon dhe vulën e Shoqërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 6 - Objekti

6.1 Në përputhje me liçensën e marrë, Shoqëria ka të drejtë:

- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozitat bankare;
- b) të japë kredi;
- c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
- ç) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- d) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- dh) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- e) të ushtrojë qiranë financiare;
- ë) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;

Susan *J* *J* *John*
V. *Steve* *Bob* *Milo* *John* *Agot*
Koco

- f) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- g) të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve metale te cmuara;
- gj) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare, këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikën 6.1 gërmë (a) dhe gërmë (b);
- h) të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore;
- i) të ushtroje shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
- j) të ushtroje shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
- k) të ushtroje shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve;
- l) të ushtrojë veprimtari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

6.2 Në përputhje me legjisacionin, për të arritur qëllimet e përmendura, pervec aktiviteteve kryesore, shoqeria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter favorizues, ndihmes, aksesor, lethesues, perfittues, aksidental dhe okazional i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimitarise së Shoqërisë.

TITULLI II KAPITALI THEMELTAR - AKSIONERËT - AKSIONET

Neni 7 - Kapitali Themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 5.250.000 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) USD.
- 7.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është kapital aksioner i cili përbëhet nga 5.250.000 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) aksione me vlerë nominale prej 1 (një) USD për aksion.
- 7.3 Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, përvëç kur përcaktohet ndryshe në këtë statut, mund të ndryshojë kapitalin aksioner si më poshtë:

The image shows several handwritten signatures in black ink, each accompanied by a printed name below it. The signatures are somewhat stylized and overlapping. The names visible are: Agjete, Tefik, Mato, and Kozmo. There are also other signatures and names that are less clearly legible or partially cut off at the bottom of the page.

- a. të zmadhojë kapitalin aksioner nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja në atë shumë sa e gjykon të pranueshme;
- b. të konsolidojë dhe të ndajë çdo ose të gjitha pjesët e kapitalit aksioner në aksione me vlerë më të madhe se sa aksionet ekzistuese;
- c. të konvertojë çdo ose të gjitha aksionet e shlyera në aksion letër me vlerë dhe të rikonvertojë aksionin letër me vlerë në aksion të thjeshtë të shlyeshëm;
- d. të pestojë aksionet, apo çdo aksion më vehte, në aksione më të vogla se sa aksionet e fiksuara në statut;
- e. të shfuqizojë aksionet të cilat në ditën e shfuqizimit, nuk janë marrë apo nuk janë pranuar për t'u marrë nga çdo person duke zgjedhur kapitalin aksioner në masën e aksioneve të shfuqizuara.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji, ndryshimi i kapitalit bëhet nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve përcakton mënyrën e ndryshimit të kapitalit aksioner, metodën e emetimit dhe të shpërndarjes së aksioneve si dhe çmimin e këtyre aksioneve.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë statut, vendos mbi mënyrën e ndryshimit të aktit të themelimit dhe të Statutit.

- 7.4 Në zmadhimin e kapitalit aksioner, aksionerët kanë të drejtë pëparësie në nënshkrim përritjen e kapitalit, proporcionalisht me shumën e aksioneve që zoterojnë.
- 7.5 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të zgjedhoje kapitalin aksioner të Shoqërisë. Në të gjitha rastet zgjedhimi i prek aksionerët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zoterojnë. Zgjedhimi i kapitalit aksioner të Shoqërisë mund të bëhet nga:
- a. veçimi dhe ulja e detyrimit për çdo aksion kur nuk është paguar;
 - b. shfuqizimi i çdo aksioni të shlyer i cili ka humbur ose nuk përfaqëson asnjë pjesë të disponueshme të aktivit të Shoqërisë;
 - c. pagimi i çdo pjese të kapitalit aksioner që përbën tepricë mbi nevojat e Shoqërisë për kapital.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionere me zgjedhimin e kapitalit aksioner ndryshon statutin sipas ndryshimeve përkatëse në kapitalin aksioner dhe në aksionet e Shoqërisë.

Neni 8 - Aksionet


8.1 Aksionet e Shoqërisë janë nominale dhe të pandashme.

The image shows several handwritten signatures in black ink, likely belonging to the shareholders mentioned in the document. The signatures are somewhat stylized and overlapping, making individual names difficult to decipher precisely. They appear to be placed below the respective shareholder names in the list.

- 8.2 Çdo aksion i Shoqërisë njeh të drejtën e një vote.
- 8.3 Aksionet e Shoqërisë mund të prezantohen në formën e çertifikatës. Çertifikata është *prima facie* vërtetim pronësie i aksionit në Shoqëri. Çertifikata nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë, Kryetari i Këshillit Drejtues dhe një anëtar i Drejtorisë i përcaktuar nga Këshilli Drejtues. Çertifikata vuloset me vulën e Shoqërisë.
- 8.4 Këshilli Drejtues mund të udhëzojë që të lëshohet një çertifikatë e re në vend të ndonjë çertifikate të lëshuar më parë nga Shoqëria të konsideruar të humbur ose të shkatërruar. Kur autorizohet lëshimi i një çertifikate të re, Këshilli Drejtues, me diskrecionin e saj dhe si një kusht paraprak për lëshimin e tyre, mund të përcaktojë afatet dhe kushtet që konsiderohen të përshtatshme, dhe mund të kërkojë dëmshpërblimet e konsideruara të përshtatshme, për të mbrojtur Shoqërinë nga ndonjë padi e cila mund të ngrihet kundër saj lidhur me çertifikatat të cilat pretendohen të kenë humbur ose të jetë shkatërruar.
- 8.5 Aksioni konsiderohet i zotuar nga aksioneri me plotësimin e kërkesave ligjore dhe me fitimin e së drejtës së pakushtëzuar për t'u regjistruar në regjistrin e aksionerëve të Shoqërisë.

Neni 9 - Aksionerët

- 9.1 Aksionerët i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet mbi aksionet e zotuara në të gjitha mbledhjet e asamblesë së Shoqërisë.
- 9.2 Përgjegjësia e aksionerit për detyrimet e shoqërisë kufizohet deri në vlerën nominale të aksionit të nënshkruar.
- 9.3 Në rast se një aksion zotërohet nga më shumë se një zotëruesh, atëherë të drejtat dhe detyrimet mbi këtë aksion ushtrohen nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi emërohet nga të gjithë zotërueshit dhe i komunikohet me shkrim e Shoqërisë. Në mungesë të përfaqësuesit, të drejtat dhe detyrimet e zotërueshve mbi aksionin pezullohen deri në emërimin e tij.
- 9.4 Transferimi *inter vivos* i aksioneve të Shoqërisë i nënshtronhet të drejtës së parablerjes në favor të aksionerëve të tjera, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 ditësh nga marja e letrës së dërguar me postë rekomande që përmban ofertën. Përcaktimet që parashikohen në këtë Nen nuk do të zbatohen për shitjet dhe transferimet e kryera nga aksionerët në favor të aksionerëve të tjera. Megjithatë, në këtë rast, transferimi duhet t'i njoftohet më parë aksionerëve të tjera me shkrim. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë Nen duhet t'i adresohen edhe Shoqërisë. Oferta për transferimin *inter vivos* te aksionit eshte e vlefshme për 20 ditë kalendareike dhe brenda këtij afati është e parevokueshme.



Në rast se Shoqëria emeton dhe ofron aksionet e saj përgjatë ushtrimit të veprimtarisë, atëherë këto aksione i ofrohen personave të tjerë vetëm kur:

- i ofrohen paraprakisht personave që zoterojnë aksionet në Shoqëri. Këto aksione ofrohen me kushte të njëjtë apo të favorshme dhe në vlerë të përafërt me vlerën nominale të aksionit në kohën e emetimit.
- afati i parashikuar për pranimin apo refuzimin e ofertës për personat që zoterojnë aksionet në Shoqëri ka mbaruar. Afati konsiderohet i mbaruar edhe kur aksionerët kanë njoftuar Shoqërinë për pranimin apo refuzimin e ofertës.

TITULLI III ORGANIZIMI, ADMINISTRIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 10 - Organet e Drejtimit dhe Administrimit

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga:

- Asamblea e Zakonshme dhe e Jashtëzakonshme e Aksionerëve;
- Këshilli Drejtues; dhe
- Drejtoria.

Neni 11 - Asambleja e Aksionerëve

11.1 Asamblea e Aksionerëve është organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë.

11.2 Asamblea e Aksionerëve përfaqësohet dhe përbëhet nga të gjithë aksionerët e Shoqërisë.

11.3 Asamblea e Aksionerëve vendos ne per gjithë organit e Shoqërisë. Vendimet e Asamblee se Aksionerëve janë te detyrueshme per te gjithe aksionerët, Këshillin drejtues, drejtorine dhe punonjesit, agentet apo perfaqesuesit e Shoqërisë.

11.4 Asambleja e Aksionerëve mund të jetë e Zakonshme apo e Jashtëzakonshme.


11.5 Asambleja e Aksionerëve mblidhet ne seline e Shoqërisë. Asambleja e Aksionerëve mund të mblidhet edhe në një vend të ndryshëm nga selia.

11.6 Asambleja e Aksionerëve thirret nga Kryetari i Asamblee me propozim te Këshillit Drejtues apo te drejtorise apo sipas keresave të ligjit. Thirja e Asamblee së Aksionerëve rregullohet nga Ligji. Propozuesi harton rendin e mbledhjes. Nje ose

disa aksionere qe zoterojne se bashku jo me pak se 5% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise mund te propozojne shtesa apo ndryshime ne rendin e mbledhjes

- 11.7 Asamblea e Aksionerëve mund te thirret nga Kryetari i Asamblese me propozim te nje ose me shume Aksionerëve qe zoterojne se bashku jo me pak se 5% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise. Propozuesi harton rendin e mbledhjes.
- 11.8 Asambleja e Aksionerëve do të konsiderohet e thirrur në mënyrën e duhur edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë procedurën e thirrjeve, me kusht që të gjithë Aksionerët janë të pranishëm apo përfaqësohen me prokurë dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtorët dhe Kontrolluesit janë të pranishëm.
- 11.9 Aksionerët të cilët janë regjistruar që prej të paktën 5 (pesë) ditësh në regjistrin e aksionerëve dhe aksionerët të cilët depozitojnë aksionet e tyre në bazë të udhëzimeve dhe afateve të përcaktuara në njoftimin e thirrjes mund të marrin pjesë në Asamblenë e Aksionerëve. Njoftimi i thirrjes duhet t'u japë mundësinë aksionerëve të huaj të depozitojnë aksionet e tyre në një bankë, e cila duhet të jetë korrespondente e një banke të autorizuar, të ndodhur në vendin ku aksioneri i huaj ka vendbanimin sipas regjistrimit të aksionerëve. Në këtë rast, aksioneri i cili dëshiron të ndjekë mbledhjen e asamblesë, duhet të depozitojë çertifikatën e depozitimit të aksioneve në bankë në vend të aksioneve.
- 11.10 Të gjitha mbledhjet Asamblesë së Aksionerëve drejtohen nga Kryetari i Asamblese apo në vend të tij nga Zëvendës-Kryetari, ose, nëse këta persona nuk janë të disponueshëm, nga një aksioner i emëruar nga Asambleja e Aksionerëve. Asambleja e Aksionerëve cakton një sekretar të mbledhjes, i cili mund të jetë ose jo aksioner.
- 11.11 Aksionerët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Aksionerëve, me një prokurë të shkruar, nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti/ja e tij/saj. Megjithatë, çdo aksioner apo person i tretë nuk mund të përfaqësojë më shumë se tre aksionerë të tjera.
- 11.12 Kryetari ka kompetenca të plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e aksionerëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve dhe të vendosë nëse ajo është e mbledhur rregullisht dhe nëse është i pranishëm *quorum-i* i aksionerëve me qëllim që të merren vendime të vlefshme; ai ka gjithashtu të drejtën të drejtojë diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.
- 11.13 Proçes-verbalet e mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga sekretari.

Neni 12 – Asambleja e Zakonshme



12.1 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve duhet të mbahet të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga fundi i vitit financiar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare të vitit të mëparshëm financiar.

12.2 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve quhet vlefshmërisht e mbledhur në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zoterojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mund të mbahet një mbledhje e dytë, pa u kërkuar ndonjë *quorum*.

12.3 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave te vlefshme te aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar. Votat e vlefshme nuk perfshijnë votat e aksionerit i cili nuk merr pjesë ne votim ose ka abstenuar ose e paraqet te bardhe ose te ndotur.

12.4 Asamblea e Zakonshme e Aksionerëve vendos ne vecanti per ceshtjet e meposhtme:

- a. te miratoje politikat e veprimtarise dhe kufijte e operacioneve te shoqerise;
- b. te miratoje buxhetin, llogarite, raportin vjetor dhe dokumentat e tjera financiare te shoqerise;
- c. te shkarkoje Këshillin Drejtues dhe Drejtorine nga detyrimi financiar per funksionet e kryera ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise;
- d. te emeroje ekspertin kontabel te autorizuar;
- e. te miratoje marreveshje te binjakezimi per administrimin dhe drejtimin e shoqerise;
- f. te miratoje shitjen e aktiveve te shoqerise mbi shumen 1.000.000 (nje milion) USD
- g. te percaktoje shperblimin e anetareve te Këshillit Drejtues, Drejtorise dhe te Kontrollit.

Ceshtjet e mesiperme mund te vendosen apo amendohen nga asambela e Jashtëzakonshme e Aksionerëve por me kusht qe te prezantohen ne mbledhjen e rrades se asamblese se zakonshme te shoqerise.

Neni 13 - Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme

13.1 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve qubet e thirrur vlefshmërisht në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm ose të përfaqësuar, të cilët zoterojnë të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe në mbledhjen e dytë nëse marrin pjesë Aksionerë, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zoterojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.

13.2 Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mbledhja e dytë mund të shtyhet për një datë të zëvëvonshme, por jo më vonë se 2 muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë.

13.3 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve vendos me një shumicë prej 3/4 (tre të katërtat) e aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar.

13.4 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave te vlefshme te aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar. Votat e vlefshme nuk perfshijnë votat e aksionerit i cili nuk merr pjese ne votim ose ka abstenuar ose e paraqet te bardhe ose te ndotur.

13.5 Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve vendos ne vecanti per ceshtjet e meposhtme:

- a. te ndryshoje statutin e shoqerise. Cdo ndryshim i statutit behet me shumicen e votave por jo me pak se 2/3 e votave te vlefshme te Aksionerëve;
- b. te miratoje marijen persiper te mjeteve, detyrimeve apo borxheve financiare te shoqerise;
- c. te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Këshillit Drejtues;
- d. te emeroje dhe shkarkoje Drejtorin e Pergjithshem;
- e. te miratoje blerjet e pasurive te paluajtshme mbi shumen 1.000.000 (nje milion) USD;
- f. te miratoje shperndarjen, bashkimin, ndarjen, shkrijen e shoqerise;
- g. te miratoje krijimin e filialeve dhe te degeve jashte Shqiperise te shoqerise.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve pervec kur percaktohet ndryshe ne ligj dhe ne dispozitat e ketij statuti, vendos per te gjitha ceshtjet e asamblese se Aksionerëve te shoqerise.

Neni 14 - Kompetencat e Këshillit Drejtues

14.1 Shoqëria drejtohet nga Këshilli Drejtues.

14.2 Këshilli Drejtues, pervec kur percaktohet ndryshe ne kete statut, per gjigjet per administrimin e Shoqërisë dhe vendos per te gjitha ceshtjet e deleguara nga Asamblea e Aksionerëve. Këshilli drejtues vendos edhe per ceshtjet te cilat nuk jane percaktuar shprehimisht per Asamblene e Aksionerëve. Per keto vendime Këshilli njofton Asamblene dhe vendimi hyn ne fuqi tre muaj pas dates se njoftimit.

14.3 Këshilli Drejtues, pervec kur percaktohet ndryshe ne kete statut, per gjigjet mbikeqyrjen e manaxhimit te Shoqerise.

14.4 Këshilli Drejtues emeron dhe shkarkon zevendes drejtoret dhe nepunesit drejtues te shoqerise.

14.5 Këshilli Drejtues kontrollon dhe mbikeqyr :


[Signature]

- a. zbatimin e ligjit, akteve nenligjore, akteve te asamblese dhe akteve te vete Këshillit;
- b. financat e shoqerise;
- c. funksionimin e strukturave organizative te shoqerise;
- d. veprimtarine e Drejtoreve.

- 14.6 Këshilli rishikion dhe mbikqyr çdo situatë aktuale apo të mundshme konflikti interesash dhe, në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Drejtoreve të gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo të mundshme të interesave apo interesave materiale që ata mund të kenë me Shoqerinë. Këshilli Drejtues nxjerr udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me Shoqerinë si dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- 14.7 Këshilli ka të drejtë të kryejë të gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet që i quan të përshtatshme për përbushjen e detyrate të tij.
- 14.8 Këshilli i paraqet Asamblesë së Zakonshme komentet e tij mbi raportin vjetor të nxjerrë nga Drejtoria.
- 14.9 Këshilli miraton kriteret e martjes në punë, vendet e punës dhe shpërbllimet e punonjësve të Shoqërisë dhe jep autorizimin për lidhjen e marrëveshjeve që kërkojnë autorizim në bazë të ligjit.

Neni 15 - Përbërja, Afati, Shkarkimi dhe Emërimi i Anëtarëve

- 15.1 Këshilli Drejtues perbehet nga 7 (shtate) anetare. Anetaret e drejtoreve janë anetare te Këshillit Drejtues. Emërimi dhe shkarkimi i anetarëve te Këshillit Drejtues behet nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve sipas dispozitave te ketij statuti.
- 15.2 Anetaret e Këshillit Drejtues ushtrojne kompetencat per një periudhe jo me te gjate se kater vjet. Anetaret e Këshillit drejtues mund te rizgjidhen.
- 15.3 Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të marrin pjesë në më shumë se 5 (pesë) Këshilla Mbikqyrës apo Drejtues të tjera të shoqërive, të cilat kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 15.4 Anetari i Këshillit Drejtues mund te shkarkohet nga detyra ne rast se :
- a. denohet nga gjykata per një veper te denueshme;
 - b. falimenton apo ështe ne procedurat e paaftesise paguese;
 - c. ështe i paaftë fizikisht dhe menderisht;
 - d. mashtron shoqerine;



The image shows several handwritten signatures in black ink, likely belonging to the members of the Board of Directors mentioned in the document. The signatures are somewhat stylized and overlapping, making individual names difficult to decipher precisely. They appear to be placed at the bottom of the page, corresponding to the list of members in section 15.4.

- e. mungon ne vazhdimesi dhe pa shkak te arsyeshem me shume se nje vit kalendarik;
- f. shkel rende etiken dhe cenon interesat e shoqerise;
- g. deklarohen si te papershtatshem per administrimin dhe manaxhimin e shoqerise per shkak te :

1. shperdorimit te detyres ndaj shoqerise;
2. shkeljes se detyrimit te besnikerise ndaj shoqerise;
3. cdo keqperdorimi te aktiveve te shoqerise;
4. cdo keqadministrimi te pasurise te shoqerise, Aksionerëve, klienteve kreditore apo debitore;
5. cdo sjelljeje qe shkakton keqperdorim apo keqadministrim te aktiveve te shoqerise dhe te pasurive si me siper;
6. cdo sjelljeje qe shkakton detyrim te pajustifikuar per shoqerine;
7. mos deklarimit te konfliktit te interesave dhe te interesave te tjera qe lidhen me veprimtarine e shoqerise;
8. mos perqatijes ne kohe te llogarive vjetore, bilancit dhe pasqyrave financiare te shoqerise;
9. kryerjes se veprimeve qe perbejne shkak per paaftesi paguese te shoqerise;
10. mos permbushjes ne kohe te detyrimeve te shoqerise megjithese eshte paguar;
11. perfundimit te operacioneve ne vlere me te vogel se operacionet normale;
12. perfitimeve personale dhe te ardhurave te ekzagjeruara ne rast se shoqeria eshte ne veshtiresi financiare

gj. Si dhe ne cdo rast tjeter te parashikuar ne nenin 21 te ligjit "Per bankat ne Republiken e Shqiperise".

15.5 Në rast vdekjeje, shkarkimi apo dorëheqje, vendet vakant duhet të zëvendësohen brenda jo më shumë se 3 muajve. Anëtari i Këshillit drejtues, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar tjetër, do të qëndrojë në detyrë për të gjithë kohën e mbetur të mandatit të paraardhësit.

Neni 16 - Kryetari, Zëvendës Kryetari dhe Sekretari

- 16.1 Kryetari dhe ne mungese te Kryetarit, Zëvendës Kryetari kanë për detyrë të thërrasin mbledhjet e Këshillit dhe të drejtojnë diskutimet.
- 16.2 Këshilli Drejtues cakton një Zëvendës-Kryetar nga anëtarët e tij. Zevendes Kryetari emërohet për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen
- 16.3 Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit mund të marrin shpërblim shtesë, të caktuar nga Asamblea e Zakonshme e Aksionerëve.
- 16.4 Këshilli drejtues mund të emërojë një sekretar.

16.5 Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Zëvendës-Kryetari.

Neni 17 - Mbledhjet e Këshillit Drejtues

- 17.1 Mbledhjet e Këshillit Drejtues zhvillohen si tregull i per gjithshem cdo muaj kalendarik por jo me pak se një here ne tre muaj kalendarik.
- 17.2 Mbledhjet e Këshillit Drejtues zhvillohen ne pranine e jo me pak se gjysmes plus një anetar te Këshillit drejtues por jo me pak se 4 (kater) anetare.
- 17.3 Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicen e thjeshte te votave. Ne rast barazie votash, vota kryetarit te Këshillit Drejtues eshte percaktuese.
- 17.4 Kryetari do te thërrasë Këshillin Drejtues brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga kërkesa e motivuar e Drejtorisë ose të 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Këshillit Drejtues. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje, kërkuesi mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar rendin e saj të ditës.
- 17.5 Thirrja bëhet 3 (tre) ditë para mbledhjes, me anë të një letre, telegrami, teleksi apo telefaksi. Thirrja mund të jetë e vlefshme edhe kur është gojore apo bëhet në çdo moment, nëse anëtarët e Këshillit Drejtues e pranojnë atë. Çdo thirrje përmban rendin e ditës të propozuar të mbledhjes.
- 17.6 Mbledhjet e Këshillit Drejtues zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çfarëdo vendi tjetër të treguar në thirrje.
- 17.7 Proçes-verbal i mbahet nga sekretari dhe nënshkruhet nga ai dhe nga Kryetari i Këshillit Drejtues. Proçes-verbalet mbahen në një regjistër të veçantë.

NENI 18 - Drejtoria

- 18.1 Drejtoria perbehet nga Drejtori i Pergjithshem, Zevendes Drejtori i Pare dhe Zevendes Drejtori i Dyte.
- 18.2 Drejtori i pergjithshem eshte dhe Kryetar i Asamblese.
- 18.3 Drejtori i pergjithshem përgjigjet per manaxhimin dhe administrimin e perditshem te Shoqërisë. Drejtori i pergjithshem përgjigjet per realizimin e te gjitha detyrave te ngarkuara nga Këshilli drejtues.

The image shows several handwritten signatures in black ink, likely belonging to the members of the Executive Board, placed over the signatures of the members of the Assembly from the previous section. The signatures are somewhat overlapping and are located at the bottom of the page.

18.4 Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve emeron dhe shkarkon Drejtorin e Pergjithshem sipas dispozitave te ketij statuti. Drejtori emërohet për një afat prej 6 vjetësh (jashtë) vjet me të drejtë rizgjedhje.

18.5 Drejtori i pergjithshem përfaqëson ligjërisht shoqërinë. Këshilli Drejtues mund perceshtje te vecanta mund te autorizoje perfaqesimin e shoqerise nga dy drejtues se bashku.

18.6 Drejtori detyrohet te informoje Këshillin Drejtues per veprimtarine dhe administrimin e perditshem te shoqerise. Këshilli Drejtues percakton me akt te vecante detyrimet e drejtorit te pergjithshem dhe procedurat per informimin e Këshillit Drejtues. Pavaresisht, Drejtori i Pergjithshem ne menyre te vecante detyrohet si me poshte:


- a. te informoje Këshillin Drejtues per veprimtarine e shoqerise;
- b. te perqatite dhe paraqese ne Keshill Drejtues pasqyrat financiare peridike;
- c. te propozoje buxhetin vjetor ne Keshill Drejtues;
- d. te propozoje planin e bisnesit ne Keshill Drejtues;
- e. te informoje Këshillin Drejtues per cdo ndryshim ne aktet ligjore dhe nenligjore qe prekin veprimtarine e shoqerise;
- f. te informoje periodikisht nje here ne muaj Këshillin Drejtues per marredheniet e shoqerise me Banken e Shqiperise dhe organet e tjera publike qe lidhen me veprimtarine eshoqerise;
- g. te informoje Këshillin Drejtues per cdo fakt ose ngjarje qe ka ose mund te preke veprimtarine e shoqerise.

18.7 Drejtori i Pergjithshem emeron dhe shkarkon personelin e shoqerise sipas kriterieve te percaktuara nga Këshilli Drejtues. Shperblimi i personelit behet nga Drejtori i Pergjithshem sipas kriterieve te percaktuara nga Këshilli Drejtues.

18.8 Përfaqësuesit e mësipërm ligjorë të shoqërisë mund të emërojnë një përfaqësues "ad negotia" për ushtrimin e detyrave apo kategorive të detyrave të veçanta, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

18.9 Në rast të ndonjë vendi vakant në Drejtori për shkak vdekje, doreheqje, shkarkimi, mungese kualifikimi apo çdo shkaku tjetër, pasardhësit do të zgjidhen nga Këshilli Drejtues në mbledhjen e parë që ndjek lënien vakant të vendit. Pasardhësi do të përfundojë mandatin e personit në vendin e të cilit ai është emëruar. Nëse shumica e anëtarëve heq dorë nga detyra, prezumohet se e gjithë Drejtoria ka hequr dorë dhe si rrjedhim Këshilli Drejtues duhet menjëherë të procedojë për emërimin e një Drejtorie të re.

18.10 Drejtorisë i jepen të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon organeve të tjera. Drejtoria i nënshtronet mbikqyrjes dhe kontrollit të Këshillit drejtues.



NOTA 18.11 Drejtori dhe zevendes drejtori shkarkohet nga detyra ne rast se vertetohen rrrethanat e parashikuara ne piken 14.4. Drejtori dhe zevendes drejtori shkarkohet edhe per shkak te nederperjes se marredhenieve te punes me Shoqerinë.

18.12 Drejtoria do te mbajë llogaritë e duhura dhe do te pregatisë pasqyrat financiare në përputhje me ligjin. Drejtoria do ti paraqesë një raport Këshillit Drejtues të paktën një herë në tre muaj. Drejtoria do ti paraqesë Këshillit Drejtues llogaritë vjetore të paktën brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit finanziar.

Neni 19 – Sekreti dhe konfidentialiteti

Pervec kur kerkohet nga ligji, anetaret e Këshillit Drejtues dhe te Drejtorise ndalothen te transmetojne te te tretet informacionin qe demton interesat e shoqerise. Anetaret e Këshillit Drejtues dhe te Drejtorise detyrohen te ruajne informacionin edhe me largimin e tyre nga keto organe.

Neni 20 - Nenshkrimet e autorizuara

Ne baze te dispozitave te ketij statuti dhe vendimeve te Këshillit Drejtues, shoqeria perfaqeshohet dhe merr persiper te drejta dhe detyrime nga nenshkrimi i autorizuar si me poshte:

- a. Me nenshkim te rangut te pare dhe te vetem nga drejtori i per gjithhem;
- b. Me nenshkim te rangut te dyte dhe se bashku te zevendes drejtoreve. Ne mungese te nje zevendes drejtori nenshkrimi i dyte zevendeshohet nga nepunes i larte te autorizuar nga drejtori i per gjithhem;


Këshilli drejtues me propozim te Drejtorit te per gjithhem percakton nenshkrimet e autorizuara sipas nivele te drejimit dhe administrimit te shoqerise.

TITULLI IV KONTABILITETI, VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE, FITIMET DHE HUMBJET, FONDET REZERVE

Neni 21 – Kontrolli brendshem

21.1 Shoqeria ka komitet kontrolli. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionerëve dhe ka këto detyra:

- a) Kontrollon dhe mbikëqyr procedurat kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshire procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, si



- dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre procedurave dhe kontrollon llogaritë bankare dhe regjistimet përkatëse.
- b) Kontrollon zbatimin e rregulloreve e të akteve të tjera dhe i raporton këshillit drejtues të bankës.
 - c) Jep mendime për të gjitha problemet që i kërkojen nga këshilli drejtues i bankës.
- 21.2 Komiteti i kontrollit mblidhet jo me pak se tre herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Drejtues. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.
- 21.3 Komiteti i kontrollit, me kërkesën e tij, ndihmohet nga ekspertë që emërohen nga këshilli drejtues.
- 21.4 Komiteti i kontrollit ushtron funksionet ne shoqeri ne perputhje me rregulloren te miratuar nga Këshilli drejtues. Këshilli drejtues rregullon veprimtarine e Komitetit te Kontrollit ne baze te propozimeve te Komitetit te Kontrollit.
- 21.5 Komiteti i kontrollit raporton dhe informon Këshillin Drejtues mbi veprimtarine e shoqerise ne cdo mbledhje te tij.
- 21.6 Asambleja e aksionerëve percakton shpërblimin për anëtarët e komitetit të kontrollit.

Neni 22 – Kontrollori i jashtem

- 22.1 Llogaritë kontabël dhe raportet financiare te shoqerise duhet të janë në formë dhe përmbytje në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ndërkombëtare, duke respektuar rregullat e përgatitjes dhe paraqitjes së llogarive kontabël të bankës, përfshirë krijimin e fondeve rezervë të duhura për aktivet e këqija e të dyshimta, si dhe për njohjen e të ardhurave e shpenzimeve.
- 22.2 Shoqeria emëron ekspertin kontabël të autorizuar me miratim te Bankes se Shqiperise. Eksperti kontabël i autorizuar duhet :
- a) të ndihmojë për mbajtjen në mënyrën e duhur të llogarive kontabël dhe të regjistimeve financiare;
 - b) të përgatitë raport vjetor së bashku me opinionet e kontrollit, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të bankës, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare në zbatim të dispozitave të këtij ligji;
 - c) të shqyrtojë mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

22.5 Eksperi kontabël i autorizuar informon Asamblene, Këshillin Drejtues dhe Banken e Shqiperise për:

- Informacionet e pergatitura sipas pikes 21.2;
- çdo veprim mashtrues të kryer nga nëpunësi i bankës, si dhe për parregullsitë dhe mangësitë në administrim ose në transakcionet që mund t'i sjellin shoqerise humbe.

Neni 23 - Viti Financiar – Inventari – Llogaritë Vjetore

23.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllt më 31 dhjetor të çdo viti.

23.2 Këshilli Drejtues mban një regjistër të irregullt të pasurisë dhe të aktivitetit të tij, në përputhje me ligjin. Në fund të vitit financiar, Këshilli Drejtues harton inventarin e pasurisë deri në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.

Neni 24 – Rezultati i Vtit Financiar dhe Përcaktimi i Fitimit

24.1 Këshilli Drejtues harton bilancin vjetor në përputhje me ligjin. 5% e fitimit neto që rezulton nga bilanci i miratuar në bazë të dispozitave të ligjit mbahet për rezervën e domosdoshme deri sa kjo rezervë të arrije 10% të kapitalit të shoqërisë.

24.2 Fitimi i mbetur shpërndahet në bazë të vendimeve të Asamblesë së Aksionerëve për shpëndarjen e dividentëve apo zërave të tjera.

Neni 25 – Shperndarja, Bashkimi, Shkrirja, Paaftesia Paguese, Nderprerja e Pagesave dhe Likuidimi

25.1 Shoqëria quhet e mbyllur në rastet e parashikuara në ligj. Në rast mbyllje, mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve emëron një apo më shumë likuidatorë, duke u dhënë atyre kompetencat përkatëse.

25.2 Shoqëria mund gjithashtu të shpërndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

Neni 26 - Dispozitë Përfundimtare

26.1 Ne rast se ka mosperputhje midis dispozitave te ketij statuti dhe marreveshjes se ortakeve apo akt themelimit atehere zbatohen dispozitat e akteve te fundit.


26.2 Ne rast se ka mosperputhje midis dispozitave te ketij statuti, atehere keto dispozita interprétohen ne kuptimin e ketij statuti, sipas qëllimit te asaj pjesë te statutit te ciles i perket, ne harmoni me pjeset e tjera te ketij statuti dhe ne perputhje me ligjin.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 356 Rep.
NR. 96 Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 31.01.2003, para meje noterit Dusho Dusha, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Zj. Monika Milo, përfaquese e Institutit Financiar Credins sh.a. me seli në "Rrugën Ismail Qemali" Nr. 11, Tirane, madhore, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, e datelindjes 07.10.1967, banuese ne rrugen Pjetër Bogdani, Pall. 23/1, ap.8, Tirane, me cilesine e administratores; Aleksandër Pilo, i datelindjes 08.04.1963, banues në Rrugën "Bajram Curri", Pall 11, shk.1 Ap. 7 Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Muhamet Malo, i datelindjes 13.05.1957, banues në rrugën "Lek Dukagjini" Pall. 11 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Renis Tërshana, i datelindjes 23.09.1971, banues në Rrugën "Shyqyri Ishmi" Nr. 17 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Artan Santo, i datelindjes 07.09.1956, banues ne Tirane ne adresen Ruga "Margarita Tutulani", Pall. BK, Ap. 8 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Maltin Korkuti, i datelindjes 17.01.1967, banues në Rrugën "Mihal Grameno" Pall 11, Ap. 9 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike per të vepruar, Ilirjan Bushati, i datelindjes 11.06.1954, banues ne Tirane, rruja Vaso Pasha, Nr.16, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Asllan Grezda, i datelindjes 08.03.1933, banues në Rrugën e Kavajës, Pall. 7 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Sejdin Zere, i datelindjes 02.04.1959, banues në Rrugën "Pjetër Bogdani" Pall 23/1, Ap. 8, Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Elena Daçi, e datelindjes 18.11.1952, banuese në Rrugën "Perlat Rexhepi", Pall 12, Ap 103, Tirane, madhore, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar dhe Leonat Koço, i datelindjes 11.01.1974, banues në Rrugën "Ismail Qemali" Nr. 31 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, të gjithë të njohur personalisht prej meje, të cilët më deklaruan përbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ANONIME “BANKA CREDINS SH.A.”**



Aksioneret themelues:

1. Instituti Financiar Credins sh.a., me seli ne Rr. “Ismail Qemali” Nr. 11, Tirane e perfaqsuar nga administratorja zj. Monika Milo.
2. Aleksander Pilo, I datelindjes 08.04.1963 banues ne Rr. “Bajram Curri” Pall. 11 Shk. 1 Ap.7 Tirane.
3. Muamet Malo, I datlindjes 13.05.1957, banues ne Rr. “Lek Dukagjini” Pall 11 Tirane.
4. Renis Tershana, I datlindjes 23.09.1971, banues ne Rr. “Shyqiri Ishmi” Nr. 17 Tirane.
5. Artan Santo, I datlindjes 07.09.1956, banues ne Rr. “Margarita Tutulani” Pall. BK Ap. 8, Tirane.
6. Monika Milo, e datlindjes 07.10.1967, banuese ne Rr. “Pjeter Bogdani” Pall. 23/1 Ap.8, Tirane.
7. Maltin Korkuti, I datlindjes 17.01.1967, banues ne Rr. “Mihal Grameno” Pall. 11 Ap. 9 Tirane.
8. Firma Bushati shpk, me seli ne Tirane e perfaqsuar nga z.Ilirjan Bushati
9. Asllan Grezda, I datlindjes 08.03.1933, banues ne Rr. “e Kavajes” Pall.7, Tirane
10. Sejdin Zere, I datelindjes 02.04.1959, banues ne Rr. “Pjeter Bogdani” Pall. 23 Ap. 8 Tirane.
11. Elena Daci, e datlindjes 18.11.1952, banuese ne Rr. “Perlat Rexhepi” P12, Ap. 103.
12. Leonat Koco, I datlindjes 11.01.1974, banues ne Rr. “Ismail Qemali”Nr. 31 Tirane.

Bien dakort te krijojne dhe rregjistrojne shoqerine anonime Banka Credins Sh A sipas ligjit, akteve nenligjore, standarteve nderkombetare, praktikave me te mira bankare, marreveshjes se ortakeve dhe statutit si me poshte :

1 – Krijimi, Emërtimi, Kohëzgjatja dhe Forma Juridike e Shoqërisë

- 1.1 Banka Credins Sh.A. eshte shoqeri anonime.
- 1.2 Emërtimi i shoqerise eshte “BANKA CREDINS SH.A.” (si me poshte “Shoqeria”).
- 1.3 Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

2 - Selia


Selia e Shoqërisë është në Rr. Ismail Qemali Nr.21 Tiranë.

3. Objekti

- 3.1 Në përputhje me licencën e marrë, Shoqëria ka të drejtë:
- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozitat bankare;
 - b) të japë kredi;
 - c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
 - ç) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
 - d) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
 - dh) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
 - e) të ushtrojë qerane financiare;
 - ë) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
 - f) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
 - g) të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve metale te cmuara;
 - gj) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare, ketu nuk perfshihen sherbimet e parashikuara ne pikën 3.1, gjermana (a) dhe (b);
 - h) të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore.
 - i) të ushtroje shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
 - j) të ushtroje shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
 - k) të ushtroje shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve.



Agim Caka



Arben Luka
Jole Murdo

I) të ushtrojë veprimtari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

- 3.2 Në përputhje me legjisacionin, për të arritur qëllimet e përmendura, pavec aktiviteteve kryesore, shoqeria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter favorizues, ndihmes, aksesor, lehtesues, perfitues, aksidental dhe okazional i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarise së Shoqërisë.

4 - Kapitali Themeltar

4.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 5.250.000 (pesemilion e dyqind e pesedhjete mijë) USD

4.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është kapital aksioner i cili përbëhet nga 5.250.000 (pesemilion e dyqind e pesedhjete mijë) aksione per kontributin ne para me vlerë nominale prej 1 (nje) USD për aksion. Ne momentin e themelimit kapitali eshte shlyer teresisht.

4.3 Kapitali aksioner ndahet si me poshte:

1. Credins sh.a. zoteron 2.169.615 (dymilion e njeqind e gjashtedhjete e nente mijë e gjashteqind e pesembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 2.169.615 (dymilion e njeqind e gjashtedhjete e nente mijë e gjashteqind e pesembedhjete) USD te cilat perbejne 41.33% te kapitalit themeltar.
2. Aleksander Pilo zoteron 837.331 (teteqind e tridhjete e shtate mijë e treqind e tridhjete e nje) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 837.331 (teteqind e tridhjete e shtate mijë e treqind e tridhjete e nje) USD te cilat perbejne 15.95% te kapitalit themeltar.
3. Muamet Malo zoteron 770.096 (shtateqind e shtatedhjete mijë e nentedhjete e gjashte) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 770.096 (shtateqind e shtatedhjete mijë e nentedhjete e gjashte) USD te cilat perbejne 14.67% te kapitalit themeltar.
4. Renis Tershana zoteron 420.000 (katerqind e njezet mijë) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 420.000 (katerqind e njezet mijë) USD te cilat perbejne 8% te kapitalit themeltar.
5. Artan Santo zoteron 308.040 (treqind e tete mijë e dyzete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 308.040 (treqind e tete mijë e dyzete) USD te cilat perbejne 5.87% te kapitalit themeltar.
6. Monika Milo zoteron 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) aksione, me nje vlore te per gjithshme nominale 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) USD te cilat perbejne 2.93% te kapitalit themeltar.

7. Maltin Korkuti zoteron 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 154.019 (njeqind e pesedhjete e kater mijë e nentembedhjete) USD te cilat perbejne 2.93% te kapitalit themeltar.
8. Firma "Bushati" shpk zoteron 123.215 (njeqind e njezet e tre mijë e dyqind e pesembedhjete) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 123.215 (njeqind e njezet e tre mijë e dyqind e pesembedhjete) USD te cilat perbejne 2.35% te kapitalit themeltar.
9. Asllan Grezda zoteron 139.690 (njeqind e tridhjete e nente mijë e gjashteqind e nentedhjete) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 139.690 (njeqind e tridhjete e nente mijë e gjashteqind e nentedhjete) USD te cilat perbejne 2.66% te kapitalit themeltar.
10. Sejdin Zere zoteron 68.975 (gjashtedhjete e tete mijë e nenteqind e shtatedhjete e pese) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 68.975 (gjashtedhjete e tete mijë e nenteqind e shtatedhjete e pese) USD te cilat perbejne 1.31% te kapitalit themeltar.
11. Elena Daci zoteron 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.
12. Leonat Koço zoteron 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) aksione, me një vlerë te per gjithshme nominale 52.500 (pesedhjete e dy mijë e peseqind) USD te cilat perbejne 1% te kapitalit themeltar.

5 - Organet e Drejtimit dhe Administrimit

5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga:


- a) Asamblea Aksionerëve;
- b) Këshilli Drejtues; dhe
- c) Drejtoria.

Organet e shoqerise per gjigjen per drejtimin dhe administrimin e shoqerise sipas statutit dhe akteve te tjera te shoqerise.

5.2 Asamblea e Aksionerëve eshte organi me i larte vendim-marrës i Shoqërisë.

5.3 Shoqëria drejtohet nga Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues per gjigjet per administrimin dhe mbikeqyrjen e manaxhimit te Shoqerise.

5.4 Drejtoria perbehet nga Drejtori i Pergjithshem, Zevendes Drejtori i Pare dhe Zevendes Drejtori i Dyte. Drejtori i per gjithshem per gjigjet per manaxhimin dhe administrimin e perditshem te Shoqërisë. Drejtori i per gjithshem përfaqëson ligjërisht shoqerinë.





- 5.5 Shoqeria ka komitet kontrolli. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionerëve dhe ushtrojne detyrat e percaktuara nga ligji dhe aktet nenligjore.

6 - Dispozita perfundimtare

Akt themelimi hyn ne fuqi ne daten e rregistrit ne rregjistrin tregtar.

Aksioneret

1. Instituti Financiar Credins sh.a., i perfaqsuar nga zj. Monika Milo.
2. Aleksander Pilo.....
3. Muammet Malo.....
4. Renis Tershana
5. Artan Santo
6. Monika Milo
7. Maltin Korkuti
8. "Bushati" shpk, perfaqsuar nga z. Ilirjan Bushati.....
9. Asllan Grezda
10. Sejdin Zere
11. Elena Daci.....
12. Leonat Koco.....




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. 357 Rep.
Nr. 27 Kol.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 31.01.2003, para meje noterit Dusho Dusha, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqiten personalisht Zj. Monika Milo, përfaqsuese e Institutit Financiar Credins sh.a. me seli në "Rrugën Ismail Qemali" Nr. 11, Tirane, madhore, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, e datelindjes 07.10.1967, banuese ne rrugen Pjetër Bogdani, Pall.23/1, ap.8, Tirane, me cilesine e administratores; Aleksandër Pilo, i datëlindjes 08.04.1963, banues në Rrugën "Bajram Curri", Pall 11, shk.1 Ap. 7 Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Muhamet Malo, i datelindjes 13.05.1957, banues në rrugën "Lek Dukagjini" Pall. 11 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Renis Tërshana, i datëlindjes 23.09.1971, banues në Rrugën "Shyqyri Ishmi" Nr. 17 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Artan Santo, i datelindjes 07.09.1956, banues ne Tirane ne adresen Rruja "Margarita Tutulani", Pall. BK, Ap. 8 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Maltin Korkuti, i datëlindjes 17.01.1967, banues në Rrugën "Mihal Grameno" Pall 11, Ap. 9 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike per të vepruar, Ilirjan Bushati, i datelindjes 11.06.1954, banues ne Tirane, rruja Vaso Pasha, Nr.16, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Asllan Grezda, i datëlindjes 08.03.1933, banues në Rrugën e Kavajës, Pall 7 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Sejdin Zere, i datëlindjes 02.04.1959, banues në Rrugën "Pjetër Bogdani" Pall 23/1, Ap. 8, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, Elena Daçi, e datëlindjes 18.11.1952, banuese në Rrugën "Perlat Rexhepi", Pall 12, Ap 103, Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar dhe Leonat Koço, i datëlindjes 11.01.1974, banues në Rrugën "Ismail Qemali" Nr. 31 Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike pë të vepruar, të gjithë të njohur personalisht prej meje, të cilët më deklaruan përbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noteri e vërtetova atë sipas ligjit.



**STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME
“BANKA CREDINS”**



Statuti i “Banka Credins” Sh.A. bazohet në ligj, aktet nënligjore, standartet ndërkombëtare, praktikat më të mira bankare dhe në marrëveshjen e ortakëve aksionerë.

TITULLI I

Neni 1 - Krijimi dhe forma juridike e Shoqërisë

- 1.1 Banka Credins Sh.A. është person juridik privat.
- 1.2 Banka Credins Sh.A. është shoqëri anonime.
- 1.3 Banka Credins Sh.A. e ushtron veprimtarinë në të gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 - Emërtimi i Shoqërisë

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “BANKA CREDINS SH.A.” (si më poshtë “Shoqëria”).
- 2.2 Emërtimi i shoqërisë në formë të shkurtuar është “BC” Sh.A..

Neni 3 - Selia, Filialet, Degët, Agjensitë dhe Zyra e Përfaqësimit.

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë. Selia e Shoqërisë është vendodhja e drejtorisë. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të vendosë nëse selia dhe drejtoria mund të janë në vendodhje të ndryshme.
- 3.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të hapë ose mbyllë seli dytësore. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të transferojë selinë e shoqërisë. Këshilli Drejtues propozon dhe publikon transferimin e selisë. Procedurat dhe publikimi i transferimit përcaktohet nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve. Transferimi i selisë dhe ndryshimet në aktet e Shoqërisë hyn në fuqi në momentin e regjistrimit.
- 3.3 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, me miratim të Bankës së Shqipërisë, mund të hapë ose mbyllë filiale të Shoqërisë në Shqipëri dhe jashtë saj.
- 3.4 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, me miratim të Bankës së Shqipërisë, mund të hapë ose mbyllë degë të Shoqërisë jashtë Shqipërisë.

Susano

V.

Thura
Afroze

Ullay

H. Hoxha
Muzi
Kafexhi

3.5

Këshilli Drejtues mund të hapë ose mbyllë çdo degë, agjensi dhe zyrë përfaqësimi, të përhershme apo jo të përhershëm, në Shqipëri.

3.6 Përsa i përket marrëdhënieve midis Shoqërisë dhe aksionerëve, vendbanimi i secilit prej aksionerëve është ai i përcaktuar në regjistrin e aksionerëve.

Neni 4 - Logo dhe Vula

4.1 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve me propozim të Këshillit Drejtues përcakton logon dhe vulën e Shoqërisë.

4.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të ndryshojë pjesërisht ose plotësisht logon dhe vulën e Shoqërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja


Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 6 - Objekti

6.1 Në përputhje me liçensën e marrë, Shoqëria ka të drejtë:

- a) të pranojë dhe të grumbullojë depozitat bankare;
- b) të japë kredi;
- c) të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - iv) instrumentet e normës së interesit;
- ç) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- d) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
- dh) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- e) të ushtrojë qiranë financiare;
- ë) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;


J. S. S.


Agjze T. L. M. L.


J. H. H. M. B. K. K.




- f) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
- g) të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve metale te cmuara;
- gj) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare, këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikën 6.1 gërmë (a) dhe gërmë (b);
- h) të bëjë edhe këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore;
- i) të ushtroje shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
- j) të ushtroje shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
- k) të ushtroje shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve;
- l) të ushtrojë veprimtari të tjera bankare dhe financiare të përcaktuara me akte nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

6.2 Në përputhje me legjislativin, për të arritur qëllimet e përmendura, pavec aktiviteteve kryesore, shoqeria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter favorizues, ndihmes, aksesor, lethesues, perfittues, aksidental dhe okazional i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarise së Shoqërisë.

TITULLI II KAPITALI THEMELTAR - AKSIONERËT - AKSIONET

Neni 7 - Kapitali Themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 5.250.000 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) USD.
- 7.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është kapital aksioner i cili përbëhet nga 5.250.000 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) aksione me vlerë nominale prej 1 (një) USD për aksion.
- 7.3 Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë statut, mund të ndryshojë kapitalin aksioner si më poshtë:



The image shows several handwritten signatures in black ink, likely belonging to the members of the Board of Directors, placed over the third point of the list above. The signatures are somewhat stylized and overlapping.

- (Official Seal of the Assembly of the State of Tirana)*
- a. të zmadhojë kapitalin aksioner nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja në atë shumë sa e gjykon të pranueshme;
 - b. të konsolidojë dhe të ndajë çdo ose të gjitha pjesët e kapitalit aksioner në aksione me vlerë më të madhe se sa aksionet ekzistuese;
 - c. të konvertojë çdo ose të gjitha aksionet e shlyera në aksion letër me vlerë dhe të rikonvertojë aksionin letër me vlerë në aksion të thjeshtë të shlyeshëm;
 - d. të pjestojë aksionet, apo çdo aksion më vehte, në aksione më të vogla se sa aksionet e fiksuara në statut;
 - e. të shfuqizojë aksionet të cilat në ditën e shfuqizimit, nuk janë marrë apo nuk janë pranuar për t'u marrë nga çdo person duke zvogëluar kapitalin aksioner në masën e aksioneve të shfuqizuara.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji, ndryshimi i kapitalit bëhet nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve përcakton mënyrën e ndryshimit të kapitalit aksioner, metodën e emetimit dhe të shpërndarjes së aksioneve si dhe çmimin e këtyre aksioneve.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë statut, vendos mbi mënyrën e ndryshimit të aktit të themelimit dhe të Statutit.

- 7.4 Në zmadhimin e kapitalit aksioner, aksionerët kanë të drejtë përparësie në nënshkrim përritjen e kapitalit, proporcionalisht me shumën e aksioneve që zoterojnë.
- 7.5 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të zvogëloje kapitalin aksioner të Shoqërisë. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek aksionerët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zoterojnë. Zvogëlimi i kapitalit aksioner të Shoqërisë mund të bëhet nga:

- a. veçimi dhe ulja e detyrimit për çdo aksion kur nuk është paguar;
- b. shfuqizimi i çdo aksioni të shlyer i cili ka humbur ose nuk përfaqëson asnje pjesë të disponueshme të aktivit të Shoqërisë;
- c. pagimi i çdo pjesë të kapitalit aksioner që përbën tepricë mbi nevojat e Shoqërisë për kapital.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionere me zvogëlimin e kapitalit aksioner ndryshon statutin sipas ndryshimeve përkatëse në kapitalin aksioner dhe në aksionet e Shoqërisë.

Neni 8 - Aksionet

- 8.1 Aksionet e Shoqërisë janë nominale dhe të pandashme.

The document is signed by several individuals, whose names are written below their respective signatures:

- Agjusht - Agjusht
- Kadri - Kadri
- Murat - Murat
- Shaban - Shaban
- Vlora - Vlora
- Zef - Zef

8.2

Çdo aksion i Shoqërisë njeh të drejtën e një vote.

8.3

Aksionet e Shoqërisë mund të prezantohen në formën e certifikatës. Certifikata është *prima facie* vërtetim pronësie i aksionit në Shoqëri. Certifikata nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë, Kryetari i Këshillit Drejtues dhe një anëtar i Drejtorisë i përcaktuar nga Këshilli Drejtues. Certifikata vuloset me vulën e Shoqërisë.

8.4

Këshilli Drejtues mund të udhëzojë që të lëshohet një certifikatë e re në vend të ndonjë certifikate të lëshuar më parë nga Shoqëria të konsideruar të humbur ose të shkatërruar. Kur autorizohet lëshimi i një certifikate të re, Këshilli Drejtues, me diskrecionin e saj dhe si një kusht paraprak për lëshimin e tyre, mund të përcaktojë afatet dhe kushtet që konsiderohen të përshtatshme, dhe mund të kërkojë dëmshpërblimet e konsideruara të përshtatshme, për të mbrojtur Shoqërinë nga ndonjë padi e cila mund të ngrihet kundër saj lidhur me certifikatat të cilat pretendohen të kenë humbur ose të jetë shkatërruar.

8.5

Aksioni konsiderohet i zotëruar nga aksioneri me plotësimin e kërkesave ligjore dhe me fitimin e së drejtës së pakushtëzuar për t'u regjistruar në regjistrin e aksionerëve të Shoqërisë.

Neni 9 - Aksionerët

- 9.1 Aksionerët i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet mbi aksionet e zotëruara në të gjitha mbledhjet e asamblesë së Shoqërisë.
- 9.2 Përgjegjësia e aksionerit për detyrimet e shoqërisë kufizohet deri në vlerën nominale të aksionit të nënshkruar.
- 9.3 Në rast se një aksion zotërohet nga më shumë se një zotëruesh, atëherë të drejtat dhe detyrimet mbi këtë aksion ushtrohen nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi emërohet nga të gjithë zotërueshit dhe i komunikohet me shkrim e Shoqërisë. Në mungesë të përfaqësuesit, të drejtat dhe detyrimet e zotërueshve mbi aksionin pezullohen deri në emërimin e tij.
- 9.4 Transferimi *inter vivos* i aksioneve të Shoqërisë i nënshtronhet të drejtës së parablerjes në favor të aksionerëve të tjera, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 ditësh nga marrja e letrës së dërguar me postë rekomande që përmban ofertën. Përcaktimet që parashikohen në këtë Nen nuk do të zbatohen për shitjet dhe transferimet e kryera nga aksionerët në favor të aksionerëve të tjera. Megjithatë, në këtë rast, transferimi duhet t'i njoftohet më parë aksionerëve të tjera me shkrim. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë Nen duhet t'i adresohen edhe Shoqërisë. Oferta për transferimin *inter vivos* te aksionit eshte e vlefshme për 20 ditë kalendarike dhe brenda këtij afati është e parevokueshme.

Afjeze Kofe
Elly
Musa

9.5

Në rast se Shoqëria emeton dhe ofron aksionet e saj përgjatë ushtrimit të veprimtarisë, atëherë këto aksione i ofrohen personave të tjerë vetëm kur :

- i ofrohen paraprakisht personave që zoterojnë aksionet në Shoqëri. Këto aksione ofrohen me kushte të njëjtë apo të favorshme dhe në vlerë të përafërt me vlerën nominale të aksionit në kohën e emetimit.
- afati i parashikuar për pranimin apo refuzimin e ofertës për personat që zoterojnë aksionet në Shoqëri ka mbaruar. Afati konsiderohet i mbaruar edhe kur aksionerët kanë njoftuar Shoqërinë për pranimin apo refuzimin e ofertës.

TITULLI III ORGANIZIMI, ADMINISTRIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 10 - Organet e Drejtimit dhe Administrimit


Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga:

- Asamblea e Zakonshme dhe e Jashtëzakonshme e Aksionerëve;
- Këshilli Drejtues; dhe
- Drejtoria.

Neni 11 - Asambleja e Aksionerëve

- 11.1 Asamblea e Aksionerëve është organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë.
- 11.2 Asamblea e Aksionerëve përfaqësohet dhe përbëhet nga të gjithë aksionerët e Shoqërisë.
- 11.3 Asamblea e Aksionerëve vendos ne per gjithë organi qështjet e Shoqërisë. Vendimet e Asamblese se Aksionerëve janë te detyrueshme per te gjithe aksioneret, Këshillin drejtues, drejtorine dhe punonjesit, agjentet apo perfaqesuesit e Shoqërisë.
- 11.4 Asambleja e Aksionerëve mund të jetë e Zakonshme apo e Jashtëzakonshme.
- 11.5 Asamblea e Aksionerëve mblidhet ne seline e Shoqërisë. Asambleja e Aksionerëve mund të mblidhet edhe në një vend të ndryshëm nga selia.
- 11.6 Asambleja e Aksionerëve thirret nga Kryetari i Asamblese me propozim te Këshillit Drejtues apo te drejtorise apo sipas kerkesave të ligjit. Thirja e Asamblese së Aksionerëve rregullohet nga Ligji. Propozuesi harton rendin e mbledhjes. Nje ose

D.Dur




Xhemal


Muza


Koko


Lulzim


Agjze

disa aksionere qe zoterojne se bashku jo me pak se 5% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise mund te propozojne shtesa apo ndryshime ne rendin e mbledhjes

- 11.7 Asamblea e Aksionerëve mund te thirret nga Kryetari i Asamblese me propozim te nje ose me shume Aksionerëve qe zoterojne se bashku jo me pak se 5% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise. Propozuesi harton rendin e mbledhjes.
- 11.8 Asambleja e Aksionerëve do tē konsiderohet e thirrur në mënyrën e duhur edhe nese nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë proçedurën e thirrjeve, me kusht që tē gjithë Aksionerët janë tē pranishëm apo përfaqësohen me prokurë dhe tē gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtoret dhe Kontrolluesit janë tē pranishëm.
- 11.9 Aksionerët tē cilët janë regjistruar që prej tē paktën 5 (pesë) ditësh në regjistrin e aksionerëve dhe aksionerët tē cilët depozitojnë aksionet e tyre në bazë tē udhëzimeve dhe afateve tē përcaktuara në njoftimin e thirrjes mund tē marrin pjesë në Asamblenë e Aksionerëve. Njoftimi i thirrjes duhet t'u japë mundësinë aksionerëve tē huaj tē depozitojnë aksionet e tyre në një bankë, e cila duhet tē jetë korrespondente e një banke tē autorizuar, tē ndodhur në vendin ku aksioneri i huaj ka vendbanimin sipas regjistrat tē aksionerëve. Në këtë rast, aksioneri i cili dëshiron tē ndjekë mbledhjen e asamblesë, duhet tē depozitojë çertifikatën e depozitimit tē aksioneve në bankë në vend tē aksioneve.
- 11.10 Të gjitha mbledhjet Asamblesë së Aksionerëve drejtohen nga Kryetari i Asamblese apo në vend tē tij nga Zëvendës-Kryetari, ose, nese këta persona nuk janë tē disponueshëm, nga një aksioner i emëruar nga Asambleja e Aksionerëve. Asambleja e Aksionerëve cakton një sekretar tē mbledhjes, i cili mund tē jetë ose jo aksioner.
- 11.11 Aksionerët mund tē përfaqësohen në Asamblenë e Aksionerëve, me një prokurë tē shkruar, nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti/ja e tij/saj. Megjithatë, çdo aksioner apo person i tretë nuk mund tē përfaqësojë më shumë se tre aksionerë tē tjerë.
- 11.12 Kryetari ka kompetenca tē plota pér tē verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, tē drejtën e aksionerëve dhe përfaqësuesve tē tyre pér tē marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve dhe tē vendosë nese ajo është e mbledhur rregullisht dhe nese është i pranishëm *quorum*-i i aksionerëve me qëllim që tē merren vendime tē vlefshme; ai ka gjithashtu tē drejtën tē drejtojë diskutimet dhe tē përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.
- 11.13 Proçes-verbalet e mbledhjeve nënskruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga sekretari.

Neni 12 – Asambleja e Zakonshme

12.1 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve duhet të mbahet të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga fundi i vitit finanziar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare të vitit të mëparshëm finanziar.

12.2 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve quhet vlefshmërisht e mbledhur në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zoterojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mund të mbahet një mbledhje e dytë, pa u kërkuar ndonjë *quorum*.

12.3 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave te vlefshme te aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar. Votat e vlefshme nuk perfshijnë votat e aksionerit i cili nuk merr pjesë ne votim ose ka abstenuar ose e paraqet te bardhe ose te ndotur.

12.4 Asamblea e Zakonshme e Aksionerëve vendos ne vecanti per ceshtjet e me poshtme:

- a. te miratoje politikat e veprimitarise dhe kufijte e operacioneve te shoqerise;
- b. te miratoje buxhetin, llogarite, raportin vjetor dhe dokumentat e tjera financiare te shoqerise;
- c. te shkarkoje Këshillin Drejtues dhe Drejtorine nga detyrimi finanziar per funksionet e kryera ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise;
- d. te emeroje ekspertin kontabel te autorizuar;
- e. te miratoje marrëveshje te binjakezimi per administrimin dhe drejtimin e shoqerise;
- f. te miratoje shitjen e aktiveve te shoqerise mbi shumen 1.000.000 (nje milion) USD
- g. te percaktoje shperblimin e anetareve te Këshillit Drejtues, Drejtorise dhe te Kontrollit.

Ceshtjet e mesiperme mund te vendosen apo amendohen nga asambela e Jashtëzakonshme e Aksionerëve por me kusht qe te prezantohen ne mbledhjen e rrades se asamblese se zakonshme te shoqerise.

Neni 13 - Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme

13.1 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve quhet e thirrur vlefshmërisht në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm ose të përfaqësuar, të cilët zoterojnë të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe në mbledhjen e dytë nëse marrin pjesë Aksionerë, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zoterojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.

Kofco
Musa Agzola

- 13.2 Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mbledhja e dytë mund të shtyhet për një datë të mëvonshme, por jo më vonë se 2 muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë.
- 13.3 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve vendos me një shumicë prej 3/4 (tre të katërtat) e aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar.
- 13.4 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave te vlefshme te aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar. Votat e vlefshme nuk perfshijnë votat e aksionerit i cili nuk merr pjese ne votim ose ka abstenuar ose e paraqet te bardhe ose te ndotur.
- 13.5 Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve vendos ne vecanti per ceshtjet e meposhtme:
- te ndryshoje statutin e shoqerise. Cdo ndryshim i statutit behet me shumicen e votave por jo me pak se 2/3 e votave te vlefshme te Aksionerëve;
 - te miratoje marjen persiper te mijeteve, detyrimeve apo borxheve financiare te shoqerise;
 - te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Këshillit Drejtues;
 - te emeroje dhe shkarkoje Drejtorin e Pergjithshem;
 - te miratoje blerjet e pasurive te paluajtshme mbi shumen 1.000.000 (nje milion) USD;
 - te miratoje shperndarjen, bashkimin, ndarjen, shkrirjen e shoqerise;
 - te miratoje krijimin e filialeve dhe te degeve jashte Shqiperise te shoqerise.

Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve pervec kur percaktohet ndryshe ne ligj dhe ne dispozitat e ketij statuti, vendos per te gjitha ceshtjet e asamblese se Aksionerëve te shoqerise.

Neni 14 - Kompetencat e Këshillit Drejtues

14.1 Shoqëria drejtohet nga Këshilli Drejtues.


14.2 Këshilli Drejtues, pervec kur percaktohet ndryshe ne kete statut, per gjigjet per administrimin e Shoqërisë dhe vendos per te gjitha ceshtjet e deleguara nga Asamblea e Aksionerëve. Këshilli drejtues vendos edhe per ceshtjet te cilat nuk jane percaktuar shprehimisht per Asamblene e Aksionerëve. Per keto vendime Këshilli njofton Asamblene dhe vendimi hyn ne fuqi tre muaj pas dates se njoftimit.

14.3 Këshilli Drejtues, pervec kur percaktohet ndryshe ne kete statut, per gjigjet mbikeqyrjen e manaxhimit te Shoqerise.

14.4 Këshilli Drejtues emeron dhe shkarkon zevendes drejtoret dhe nepunesit drejtues te shoqerise.


14.5 Këshilli Drejtues kontrollon dhe mbikeqyr :


gj.











DPLM

- a. zbatimin e ligjit, akteve nenligjore, akteve te asamblese dhe akteve te vete Këshillit;
- b. financat e shoqerise;
- c. funksionimin e strukturave organizative te shoqerise;
- d. veprimtarine e Drejtorese.

- 14.6 Këshilli rishikion dhe mbikqyr çdo situatë aktuale apo të mundshme konflikti interesash dhe, në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Drejtorese të gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo të mundshme të interesave apo interesave materiale që ata mund të kenë me Shoqërinë. Këshilli Drejtues nxjerr udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me Shoqërinë si dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- 14.7 Këshilli ka të drejtë të kryejë të gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet që i quan të përshtatshme për përbushjen e detyrave të tij.
- 14.8 Këshilli i paraqet Asamblesë së Zakonshme komentet e tij mbi raportin vjetor të nxjerrë nga Drejtoria.
- 14.9 Këshilli miraton kriteret e marrjes në punë, vendet e punës dhe shpërblimet e punonjësve të Shoqërisë dhe jep autorizimin për lidhjen e marrëveshjeve që kërkojnë autorizim në bazë të ligjit.

Neni 15 - Përbërja, Afati, Shkarkimi dhe Emërimi i Anëtarëve

- 15.1 Këshilli Drejtues perbehet nga 7 (shtate) anetare. Anetaret e drejtorese janë anetare te Këshillit Drejtues. Emërimi dhe shkarkimi i anetarave te Këshillit Drejtues behet nga Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionerëve sipas dispozitave te ketij statuti.
- 15.2 Anetaret e Këshillit Drejtues ushtrojne kompetencat per një periudhe jo me te gjate se kater vjet. Anetaret e Këshillit drejtues mund te rizgjidhen.
- 15.3 Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të marrin pjesë në më shumë se 5 (pesë) Këshilla Mbikqyrës apo Drejtues të tjera të shoqërive, të cilat kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 15.4 Anetari i Këshillit Drejtues mund te shkarkohet nga detyra ne rast se :
- a. denohet nga gjykata per një veper te denueshme;
 - b. falimenton apo eshte ne procedurat e paaftesise paguese;
